



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 tetor 2024
Nr. ref.:RK 2560/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI151/24

Parashtrues

N.T. "SPORTING"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit K.Dh.Shk.II.nr.1276/23 të 5
marsit 2024 të Gjykatës Komerciale të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga N.T."SPORTING", me seli në Prizren (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Visar Ostrozubi, avokat në Komunën e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [K.Dh.Shk.II.nr. 1276/23] të 5 marsit 2024 të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e shkallës së dytë (në tekstin e mëtejme: Dhoma e shkallës së dytë), në ndërlidhje me Aktvendimin [KPPP. nr. 2210/22] e 28 korrikut 2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejme: Dhoma e shkallës së parë).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 22 mars 2024.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 korrik 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
7. Më 13 gusht 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR.KI151/24] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 15 gusht 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës së parashtruesit të kërkesës iu dërgua Dhomës së shkallës së dytë, të cilës iu kërkua edhe fletëkthesa që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi i kërkesës aktvendimin e kontestuar.
9. Më 19 gusht 2024, Dhoma e shkallës së dytë e dërgoi fletëkthesën që dëshmon se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktvendimin e kontestuar më 22 mars 2024.
10. Më 25 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se I.E., si pronar individual i biznesit N.N.SH. "P&I", me seli në Komunën e Kaçanikut (në tekstin e mëtejme: debitori) kishte fituar tenderin publik [617-17-1708-5-2-1] në Komunën e Shtimes për "Ndërtimin e Palestrës Sportive në Shtime". Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me kërkesë të debitorit, kishte ofruar çmimin prej 89.845.60 euro për vendosjen e gjashtë rendeve me tribuna teleskopike për realizimin e projektit të fituar sipas kontratës së prokurimit publik. Sipas parashtruesit të kërkesës, debitori e kishte bërë pagesën e pjeshme të detyrimit në shumën prej 57.000 euro, mirëpo nuk e pagoi shumën e mbetur të detyrimit prej 32.845.00 euro duke e refuzuar nënshkrimin e faturës përkatëse. Në anën tjetër, debitori pretendonte se e kishte përmbushur në tërësi detyrimin në shumën prej 57.000.00 euro, për të cilën kishin rëndë dakord me rastin e marrëveshjes për vendosjen e gjashtë rendeve me tribuna teleskopike.
12. Më 3 shkurt 2021, Përmbaruesi Privat nxori Urdhrin Përmbarimor [P. nr. 704/21] [në tekstin e mëtejme: Urdhri përmbarimor], me të cilën e obligoi debitorin të kryejë pagesën në shumën prej 32.845.60 euro ndaj parashtruesit të kërkesës. Urdhri përmbarimor ishte nxjerrë sipas propozimit të parashtruesit të kërkesës, i cili e kishte paraqitur një Faturë [nr.287] të 31 dhjetorit 2018 (në tekstin e mëtejme: fatura) dhe pretendonte se është dokument i besueshëm për përmbarim ndaj debitorit.
13. Më 16 shtator 2022, debitori paraqiti prapësim përmbarimor në Dhomën e shkallës së parë kundër Urdhrit përmbarimor, me arsyetimin se e kishte realizuar pagesën në shumë prej 57.000 euro ndaj parashtruesit të kërkesës, që dëshmohej përmes faturave dhe nuk kishte mbetur asnjë detyrim i papaguar.
14. Më 19 shtator 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në prapësim ndaj debitorit, me arsyetimin se debitori nuk i kishte realizuar të gjitha pagesat për kryerjen e punimeve, të përcaktuara nga kontrata që e kishin nënshkruar.
15. Më 28 korrik 2023, Dhoma e shkallës së parë përmes Aktvendimit [KPPP. nr. 2210/22] aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe anuloi Urdhrin përmbarimor. Gjykata theksoi se Urdhri përmbarimor është nxjerrë sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejme: LPP) , i cili përcakton se organi përmbarues e cakton dhe e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm. Shkalla e parë iu referua paragrafit 1 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se "*Përmbarimit me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*" dhe paragrafit 3 të këtij neni që përcakton se "*Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Në rastin konkret, Shkalla e parë vlerësoi se fatura në bazë të së cilës u lejua propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, sepse ishte lëshuar në mënyrë të njëanshme nga parashtruesi i kërkesës dhe nuk ishte pranuar nga debitori. Shkalla e parë theksoi se e-maili i dërguar nga parashtruesi i kërkesës në drejtim të debitorit nuk është provë që dëshmon se fatura ishte pranuar nga debitori. Shkalla e parë vlerësoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me çmimet e përcaktuara gjatë realizimit të kontratës ndërmjet tij dhe debitorit, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore sepse procedura përmbarimore i nënshtrohet rigorozitetit formal dhe aty vlerësohen vetëm elementet formale të dokumentit mbi të cilin është lejuar përmbarimi.
16. Parashtruesi i ankesës paraqiti ankesë në Dhomën e shkallës së dytë kundër aktvendimit të Dhomës së shkallës së parë, për shkak të shkeljeve esenciale të

dispozitive procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës theksoi se fatura i përmban të gjitha elementet ligjore për të qenë dokument i besueshëm pasi buron nga puna juridike ndërmjet tij dhe debitorit. Sipas parashtruesit të kërkesës, fakti që ka pasur një punë juridike dhe fatura ishte dërguar në formë elektronike dëshmon se detyrimi nuk është përmbushur nga debitori.

17. Më 5 mars 2024, Dhoma e shkallës së dytë përmes Aktvendimit [K. Dh. Shk. II.nr. 1276/23] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktvendimin e Dhomës së shkallës së parë. Dhoma e shkallës së dytë vlerësoi se fatura nuk përmban elementet që kërkojnë me paragrafin 3 të nenit 29 të LPP-së. Dhoma e shkallës së dytë iu referua Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për zbatimin e Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, paragrafit 1 të nenit 20, i cili përcakton se *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore”*. Sipas vlerësimit të Dhomës së shkallës së parë, nuk ka prova që dëshmojnë se fatura është pranuar nga debitori, sepse ajo nuk është nënshkruar e as vulosur nga debitori. E-maili i dërguar nga parashtruesi i kërkesës në drejtim të debitorit, nuk është provë që dëshmon se debitori e ka konfirmuar pranimin e faturës. Prandaj, fatura e paraqitur nuk mund të konsiderohet si dokument i përshtatshëm për përmbarim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimi i Dhomës së shkallës së dytë është në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka dhënë mbrojtje ligjore një fature e cila rrjedh nga puna e vlefshme juridike e lidhur nga palët, duke i vlerësuar vetëm anën formale të faturës, nëse ajo ishte e nënshkruar nga debitori, pa i vlerësuar rrethanat e ekzistimit dhe pranimit të detyrimit nga debitori.
20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Dhoma e shkallës së dytë ka zbatuar praktika të ndryshme juridike për raste të ngjashme. Në disa raste i ka vlerësuar si dokumente të besueshme edhe faturat pa nënshkrimin e debitorit. Parashtruesi i kërkesës i referohet Aktvendimit [PPP. nr. 167/21] të Gjykatës Themelore në Prizren, të 14 shkurtit 2022, ku sipas tij kjo e fundit kishte vlerësuar një faturë si dokument të përmbarueshëm edhe përkundër mungesës së nënshkrimit nga debitori. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe Aktvendimit [K. DH. SH. II. nr. 233/2023] të Shkallës së dytë, të 10 majit 2023, e cila e kishte konfirmuar faturën si dokument të përmbarueshëm në mungesë të nënshkrimit nga debitori.
21. Parashtruesi i kërkesës thekson se në asnjë fazë të shqyrtimit gjyqësor nuk është mbajtur seancë dëgjimore, duke i mohuar palës të drejtën e parashtrimit të pretendimeve.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...].

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 27

Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor

1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.
- [...]

Neni 29

Dokumentet e besueshme

1. Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është:
[...]
1.3. faturat;
[...]

Neni 37

Përmbarimi në bazë të dokumentit të besueshëm

Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 47 dhe 48 të Ligjit.

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

24. Përkitazi me përmbushjen e kritereve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës; konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [K. Dh. Shk. II. nr. 1276/23] e 5 marsit 2024 të Dhomës së shkallës së dytë, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
25. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e përcaktuara me paragrafin 2, të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk e mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

26. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me

ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave, si "pretendime qartazi të pabazuara". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"; (iii) pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara", atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GJEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime "konfuzë dhe të paqarta" (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr.17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituaniës](#), nr.71074/01, Vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03).

27. Gjykata rikujton se, parashtruesi i kërkesës pretendonte se debitori nuk ia kishte paguar detyrimin në shumën prej 32.845.00 euro dhe për këtë arsye paraqiti propozim të përmbaruesi privat për ekzekutimin e mjeteve financiare. Përmbaruesi nxori urdhrin përmbarimor me të cilin e detyroi debitorin për realizimin e detyrimit, duke u bazuar në një faturë të cilën e kishte dorëzuar parashtruesi i kërkesës. Dhoma e shkallës së parë dhe Dhoma e shkallës së dytë, duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, anuluan urdhrin përmbarimor me arsyetimin se fatura e dorëzuar nuk është dokument i përshtatshëm për përmbarim sepse ishte e nënshkruar vetëm nga parashtruesi i kërkesës dhe jo nga debitori, rrjedhimisht ishte e njëanshme. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e Dhomave të Gjykatës Komerciale janë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, sepse në një rast tjetër e kishin pranuar faturën si dokument të përshtatshëm për përmbarim përkundër faktit që nuk ishte e nënshkruar nga debitori; dhe në asnjë shkallë nuk u mbajt seanca dëgjimore. Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, përkritazi me divergjencën e praktikës gjyqësore dhe mosmbajtjen e seancës dëgjimore.

Në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 31 dhe 24 të Kushtetutës, përkritazi me nenin 6 të KEDNj-së

(i) përkritazi me divergjencën e praktikës gjyqësore

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Dhoma e shkallës së dytë ka pasur një praktikë të ndryshme në raste të ngjashme, ku faturat janë pranuar edhe pa nënshkrimin e debitorit. Parashtruesi i kërkesës i referohet Aktvendimit [PPP. nr. 167/2021] të 14 shkurtit 2022 të Gjykatës Themelore në Prizren dhe Aktvendimit [K. DH. SH. II. nr. 233/2023] të 10 majit 2023 të Dhomës së shkallës së dytë. Sipas tij, këto divergjenca të praktikës gjyqësore janë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.

29. Gjykata ripërsërit se nuk është funksioni i saj të krahasojë vendimet e gjykatave të rregullta (shih, rastet e Gjykatës, [KI249/23](#), *parashtrues Halidin Aliu*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 korrikut 2024, paragrafi 39; [KI175/20](#), *parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 marsit 2021, paragrafi 61). Gjykata nuk mund të vë në pikëpyetje interpretimet e gjykatave të rregullta, për sa kohë që nuk janë arbitrare. Gjykata e ka parasysh që mund të ketë vendime kundërthënëse nga gjykatat e rregullta, e cila është karakteristikë e sistemit gjyqësor dhe në vetvete nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës. Për t'u konsideruar se ekzistojnë divergjenca në vendimmarrjen e gjykatave të rregullta, ato duhet të jenë të thella dhe afatgjata (shih, rastet e GJEDNj-së, *Filippa Roberta LO FERMO kundër Italisë*, [nr. 58977/12](#), Vendim i 20 qershorit 2023, paragrafët 59-60; *Lupeni Greek Catholic Parish and Others kundër Rumanisë*, [nr.76943/11](#), Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 116).
30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës dhe debitori kishin lidhur marrëveshje për vendosjen e disa tribunave teleskopike. Debitori kishte realizuar pagesën në shumën prej 57.000 euro te parashtruesi i kërkesës dhe një gjë e tillë nuk ishte kontestuese. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës pretendonte se detyrimi nuk ishte përmbushur në tërësi dhe kërkoi realizimin e një pagese shtesë në shumën prej 32.845.60 euro. Për këtë arsye, ai paraqiti një propozim për përmbarim, duke e dorëzuar një faturë që sipas tij dëshmonte që debitori nuk e kishte realizuar detyrimin në fjalë. Përmbaruesi privat lëshoi një urdhër përmbarimor dhe obligoi debitorin të kryejë pagesën në shumën e kërkuar prej 32.845.60 euro.
31. Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, Dhoma e shkallës së parë me aktvendimin e 28 korrikut 2023 e anuloi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se, sipas paragrafit 1 të nenit 29 të LPP-së përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Mirëpo, sipas paragrafit 3 të nenit 29 të këtij neni, dokumenti është i përshtatshëm për përmbarim nëse në të është treguar kreditori dhe debitori, objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Në rastin konkret, Dhoma e shkallës së parë vlerësoi se fatura të cilën e kishte dorëzuar parashtruesi i kërkesës nuk ishte dokument i besueshëm për përmbarim sipas kriterëve ligjore sepse nuk ishte nënshkruar nga debitori por vetëm nga parashtruesi i kërkesës. Rrjedhimisht, debitori nuk e kishte pranuar ekzistencën e faturës por ajo ishte lëshuar në mënyrë të njëanshme nga parashtruesi i kërkesës.
32. Dhoma e shkallës së dytë refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe u pajtua me vlerësimin e Dhomës së shkallës së parë. Në aktvendimin e 5 marsit 2024, Dhoma e shkallës së dytë arsyetoi se fatura e parashtruesit të kërkesës nuk përmban elementet që kërkohen me paragrafin 3 të nenit 29 të LPP-së për t'u konsideruar dokument i përshtatshëm për përmbarim. Për më tepër, Dhoma e shkallës së dytë iu referua paragrafit 1 të nenit 20 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për zbatimin e Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, që përcakton se një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi dhe nga klienti. Fatura të cilën e kishte lëshuar parashtruesi i kërkesës nuk ishte e nënshkruar dhe e vulosur nga debitori prandaj nuk mund të konsiderohet dokument i besueshëm për përmbarim.
33. Në lidhje me aktvendimet që i referohet parashtruesi i kërkesës, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ia ka bashkëngjitur kërkesës aktvendimin e Dhomës së shkallës së dytë, për të cilin pretendon se përmban divergjenca të praktikës gjyqësore sa i përket pranimit të faturës si dokument i besueshëm edhe pa nënshkrimin e debitorit. Për më tepër, Gjykata rithekson se nuk mund të konstatohet divergjencë e praktikës gjyqësore me krahasimin e vetëm 2 (dy) rasteve, edhe nëse të njëjtat mund të jenë kundërthënëse (shih, rastet e Gjykatës, [KI205/23](#), *parashtrues Ramadan Hyseni, Shkumbin Vidishiqi, Mimoza Abazi, Zymer Haliti dhe Gani Selimi*, Aktvendim për

papranueshmëri i 29 prillit 2024, paragrafi 72; [KI102/22](#), *parashtrues Faton Aliu*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2023, paragrafi 59).

34. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me divergjencën e praktikës gjyqësore, janë pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” prandaj shpallen qartazi të pabazuara.

(ii) *përkitazi me mosmbajtjen e seancës dëgjimore*

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Komerciale në asnjë fazë të shqyrtimit gjyqësor nuk ka mbajtur seancë dëgjimore, duke i mohuar të drejtën e parashtrimit të pretendimeve të tij. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij ndaj aktvendimit të Dhomës së Shkallës së Parë kërkoi mbajtjen e seancës dëgjimore për vërtetimin e rrethanave të rastit.
36. Gjykata rithekson se, e drejta për “tu dëgjuar” është një nga komponentët e procesit të rregullt gjyqësor. Kjo e drejtë kontribuon që administrimi i drejtësisë të jetë i hapur dhe që besimi i publikut te gjykatat të ruhet (rasti i GJEDNJ-së, [Malhous kundër Republikës Ceke](#), nr. 33071/06, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 54). Megjithatë, në disa rrethana mund të bëhet përjashtim nga kjo e drejtë, për shembull, në çështjet kur natyra juridike e rastit ka të bëjë thjesht me interpretime të ligjit, apo me çështje krejtësisht teknike (rasti i GJEDNJ-së, [Koottummel kundër Austrisë](#), nr. 49616/06, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009, paragrafi 19; rasti i GJEDNJ-së, [Miller kundër Suedisë](#), nr. 55853/00, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 29; shih, rastet e Gjykatës [KI186/19](#), [KI187/19](#), [KI200/19](#), [KI208/19](#), *parashtrues Belkize Vula Shala dhe të tjerët*, Aktgjykim i 28 prillit 2021, paragrafët 62 dhe 74; rastet [KI145/23](#), [KI146/19](#), [KI147/19](#), [KI149/19](#), [KI150/19](#), [KI151/19](#), [KI152/19](#), [KI153/19](#), [KI154/19](#), [KI159/19](#), [KI156/19](#), [KI157/19](#), [KI159/19](#), *parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 68).
37. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se paragrafi 1 i nenit 73 [Vendosja sipas prapësimit] të LPP-së përcakton se vendimi lidhur me prapësimin mund të merret jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht, Gjykata Komerciale mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Në rastin konkret, çështja lidhet me interpretimin e ligjit, nëse fatura të cilën e kishte dorëzuar parashtruesi i kërkesës mund të konsiderohet si dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim sipas LPP-së. Dhomat e Gjykatës Komerciale nuk kishin dilema për të kuptuar ligjshmërinë e prapësimit të debitorit prandaj mbajtja e seancës dëgjimore nuk ishte e domosdoshme në këtë rast.
38. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, përkitazi me mosmbajtjen e seancës dëgjimore, i përkasin pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe rrjedhimisht shpallen si qartazi të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47.1 të Ligjit dhe me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, më 25 shtator 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani